

PKR.nr.97/17

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me gjyqtaren Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues dhe sekretaren juridike, Arbnore Idrizi, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të pandehurit A. G., për shkak të veprës penale, Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1059/2017, të datës 14.03.2017, në seancën e shqyrtimit fillestar të hapur, verbale, të mbajtur me dt.**21.03.2017**, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Ilaz Beqiri, të akuzuarit, A. G. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, avokat A. A., në bazë të nenit 366 të KPPK-së, të njëjtën ditë mori dhe publikisht në prezencë të palëve e shpalli, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: A. G.**, me nofkën A. . . /D. nga i ati Sh. dhe nënës S., e vajzërisë G., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin M., Lagjia B., Komuna e P., ka të kryer shkollën fillore, me profesion pylltar, i pa pune, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit nga data 17.02.2017 deri me datën 21.03.2017,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:** Me date 17.02.2017, rreth orës 22:40, ne rrugën “Shaban Shala” në Prishtinë, pa autorizim ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, ka mbajtur ne pronësi dhe ka poseduar armen e tipit “Mauser-Verke” Model HSO, me nr serik 0132360, prodhim gjerman, me dy karikator dhe 13 fishek te kalibrit 9mm, arme funksionale, e cila pas identifikimit nga policia është konfiskuar,-

- me këtë ka kryer veprën penale, Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7; 17; 21; 41; 42; 46; 62; 69; 73 dhe 83 të KPRK-së, dhe neneve 248; 359; 365 dhe 366 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME GJOBE**

- Në shumë prej 650 € (gjashtëqind e pesëdhjetë euro), të cilin gjobë është i obliguar që ta paguaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Koha e kaluar në paraburgim nga data 17.02.2017 deri me datën 21.03.2017, do ti llogaritet në dënimi e shqiptuar, duke iu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgim si dhe

**DËNIM PLOTËSUES**

- Konfiskohet arma e tipit “Mauzer-Verke model HSO me nr serik 0132360, prodhim gjerman me dy karikator dhe 13 fishek të kalibrit 9mm, armë funksionale, si mjete që janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **njëzet e pesë euro (25 €)**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1059/17, të datës 14.03.2017, kundër të akuzuarit A. G., për shkak të veprës penale, Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së,

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.03.2017, ku prezantuan Prokurori i Shtetit Ilaz Beqiri, i pandehuri A. G. me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare avokati A. A..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari A. G. pranoi fajësinë dhe deklaroi se ndihet fajtor për veprën penale, këtë pranim e bëri me vullnet, pa presion dhe duke qenë i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë e pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i njëjti premtoi gjykatës se nuk do të përsërisë vepra te tilla apo te ngjajshme,

Mbrojtësi i të akuzuarit A. G., av.A. A. deklaroi se pas konsultimit me të mbrojturin e tij kanë vendosur që të pranojnë fajësinë dhe ky pranim është bërë vullnetarisht, kërkoi nga gjykata te merr parasysh gjitha rrethanat që i parasheh ligji me rastin e shqiptimit te sanksionit penal, rrethanën lehtësuese se i akuzuari është i ri, se pranimin e fajësise e ka bërë me vullnet të plotë dhe i propozoi gjykatës që ta dënoi me nje dënim të kushtëzuar.

Konform nenit 248 par.2 të KPP-së, Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, i njëjti pranim është në përputhje me nenin 248 par.1 të KPP-së, i cili është në përputhje të plotë me aktakuzën e cila është e mbështetur në provat dhe shkresat e lëndes andaj i propozoj gjykatës që këtë pranim të aprovoj dhe i akuzuari të dënohet sipas ligjit, dhe të njëjtit ti ndërpritet masa e paraburgimit, meqë kane pushuar te gjitha shkaqet ligjore për të cilat është caktuar kjo masë.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga ana e të akuzuarit, gjykata konform nenit 248 par.4 të KPP-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë të të akuzuarit, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit A. G., ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për veprën e kryer penale, sinqeritetin e tij deklarues, premtimin se nuk do të përsëris apo nuk do të kryej ndonjë vepër penale, i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti, andaj të akuzurit i shqipoj dënim me gjobë, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenin 73 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 62; 69 dhe 374 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 dhe 453 par. 1 të KPPK-së.

Vendimi mbi ndërprerjen e masës së paraburgimit, është marrë në bazë të nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.97/17, datë 21.03.2017**

**Sekretarja juridike  
Arbnore Idrizi**

**Kryetarja e trupit gjykues  
Valbona Musliu-Selimaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së vendimit për Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate.